

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. K. nga fsh. B. K.Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontrolli ose posedimi te paautorizuar te armëve nga 374/1 te KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, P.nr.112/17 të datës 14.02.2017 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **13.07.2017**, në prani të Prokurorit te shtetit Ramiz Buzhala dhe te akuzuarit F. K., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. K.**, data e lindjes..., ne fsh. B. K. Gjakovë, ku dhe tani banon , i biri i S. dhe i nënës D. e gjinisë A., ka te kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, me ID....

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- Ditën kritike me datë 19.01.2017 rreth orës 10.05 h, në pikën kufitare “Q. P.”, mban në pronësi ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla (Ligji për armë nr. 05/L-022) , në atë mënyrë që gjatë një kontrolli në detaje nga ana e policëve të veturës të llojit “B.” me targa të regj..., e cila evidentohet pronë e të pandehurit, i janë gjetur revolja e tipit gjashqe e prodhimit kinez me numër serik #T671484, si dhe 5 fishek të kalibrit 6x35mm, të njëjtat në cilësi të provave materiale i janë konfiskuar dhe gjenden në ruajtje në dhomën e dëshmive dhe me Urdhëresë të prokurorit janë dërguar në Laboratorët e AKF-së për ekzaminim .

-me çka ka kryer vepër penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par. 1 te KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,43,46,73 dhe nenit 374/1 të KPRK-ës, dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit F. K. i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ne shumen prej 700(shtatëqind) euro, te cilin dënim është i detyruar ta paguaj ne 3(tri) këste ne afatin prej 3 (tre) muajve nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit dhe atë kësti i pare ne shume prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te pare pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, kësti i dyte prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te dytë, kësti i tretë prej 200 (dyqind) euro do të paguhet deri me datën 5 të muajit të tretë ,pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit .

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh duke ia llogaritur 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi .

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë ne emër te paushallit gjyqësorë shumën prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Konfiskohet revolva e tipit gjashqe e prodhimit kinez me numër serik #T671484, si dhe 5 fishek të kalibrit 6x35mm, si objekt i kryerjes se veprës penale dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të shkatërrohen .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.112/17 të dt.14.02.2017, e ka akuzuar të akuzuarin F. K. nga fsh. B.K. Gjakovë, për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontrolli ose posedimi te paautorizuar te armeve nga 374/1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, pas leximit te aktakuzës PP.nr.112/17 të dt.14.02.2017, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe konform nenit 374 par. 3 të KPRK-ës të konfiskohet arma e përshkruar në dispozitiv dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi arma të shkatërrohet plotësisht. Në fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga i akuzuari e që u bë i lirshëm e i vullnetshëm duke i kuptuar pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë u vërtet mjaftë edhe pse nga shkresat e lëndës ka edhe prova tjera bindëse se ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi , kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës., e gjykatës i propozoi që të njëjtin ta shpall fajtor për shkallën e përgjegjësisë penale dhe ta dënoi sipas ligjit dhe ta detyroi në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

I akuzuari F. K., gjate shqyrtimit fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion. Në fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprimet e kryera, premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe se edhe për kundër faktit i vetë e kam blerë, kam tentuar që të njëjtën t'ia kthejë të cilit ja kam blerë me qenë se edhe vetë nuk kam qenë i interesuar ta mbajë sepse nuk më është nevojitur për asgjë, dhe të njëjtën nuk e kam keq përdorë dhe që nga dita e blerjes e kam lënë në makine, andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer , premtimi se ne te ardhmen nuk do ta përsërisë ndonjë vepër penale apo te ngjashme ,gjendjen e varfër ekonomike , si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptoj një dënim me te butë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, si raporti i oficerit K. A. PK #...., i dt.19.01.2017, Vërtetimi për konfiskimin e armës dhe municionit i dt. 19.01.2017, deklarata e të pandehurit në st. Policor dhe në prokurorin Themelore, fotoalbumi i armës, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit .Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marr parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, moshën në kohën e kryerjes së veprës penale ,premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës , të cilat rrethana kanë ndikuar që të akuzuarit F. K. ti shqiptohet dënimin me gjobë ne shumën prej 700(shtatëqind) euro, me bindjen e plote se ky dënim është ne harmoni me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë se te akuzuarit dhe se Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarit do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës .

Vendimi për konfiskimin e revoles e tipit gjashqe e prodhimit kinez me numër serik #T671484, si dhe 5 fishek të kalibrit 6x35mm, është marr bazuar ne nenin 374/3 te KPRK-ës .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.145/17 më datë 13.07.2017.**

**Sekretarja juridike,
Nushe Kadrija**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** , nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.